



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM Nr 4 Date 28.01.2020

“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI FAMILJEN E Z. FATOS MEHMETI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, udhëzimin nr. 23, datë 30.12.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për përmbajtjen e bonusit të strehimit”, referuar dokumentacionit të përgatitur nga komisioni i verifikimit në terren të objektit shtëpi banimi të z. Fatos Mehmeti në zbatim të VKM nr. 329 date 16.05.2012 “ Per kriteret dhe procedurat e dhenies së ndihmes shtetore financiare për mbulimin e detyrës së shkaktuara nga fatkeqesia natyrore ose fatkeqesia të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në proces verbalin e konstatimit date 14.12.2019 është konkluduar që objekti është pothuajse i amortizuar si dhe termi i dates 26.11.2019 ka krijuar plasaritje dhe çarje në strukture duke u shprehur se ky objekt është i pabanueshem për kohësishte. Sipas kontratës së qerases date 07.01.2020 me nr. 28 rep. familja e z. Fatos Lutfi Mehmeti është sistemuar me qera në një banesë private. Në kontratën e qerases vlera mujore e pageses është 22000 mij/lek. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e këshillit bashkiak të dates 28.01.2020 miratoi me 18 vota pro

VENDOSI :

- I.** Të miratojë trajtimin me bonus strehimi në vlerën 50 % të vlerës së qerases familjen e z. Fatos Lutfi Mehmeti në shumën 11000 (njembedhjetë mijë) lekë në muaj,
- II.** Efektet financiare që rrjedhin nga pika “I”, në shumën prej 11000 (njembedhjetë mijë) lekë në muaj, do të përballohen nga buxheti i shtetit.
- III.** Efektet financiare kanë një kohëzgjatje nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri në zgjidhjen e problemit të strehimit në banesën e tij.
- IV.** Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.

Sekretare Këshilli
Inva Trupja



2020

Kryetar Këshilli
Sokol Sava

